

Ismail ISMAILI

**DOKUMENT I BASHKËNGJITUR DEPESHËN E 11 MAJIT 1864
(D. I KONSULLATËS NR. 16). KONSULLATA E FRANCËS NË
SHKODËR.¹
MEMORIE MBI PASHALLËKUN E PRIZRENIT SHTRIRJA DHE
KUFIJTË**

Pashallëku i Prizrenit (vilajeti i Shkupit) ka një shtrirje prej 1 080 kilometra katrorë, që kufizohet në lindje me Maqedoninë, në veri me Servinë (Serbinë v.a.), në jug me sanxhakun e Shkodrës që lumi Drin formon kufirin natyror dhe në perëndim me Bosnjën dhe pashallëkun e Nishit. Duke kaluar Drinin në Spas dhe ngaqë përshkon trekëndëshin e formuar nga Drini i Bardhë dhe Drini i Zi që përndryshe merr emrin Drini i bashkuar, dalim në fushën e Metohisë, e cila ka një gjatësi prej dyzet e tetë kilometrash dhe njëzet e katra e gjerë dhe që shtrihet drejt Pejës dhe është e rrethuar në lindje me një zinxhirë të vogël malesh, të cilën e ndajnë nga fusha e gjerë e Kosovës, në hyrje të së cilës rrjedh lumi i madh Sitnicë. Fushat e Pejës, të Kumanovës, të Moravës dhe të Gjakovës, relativisht janë më shumë pjellore sesa ajo e Kosovës, ku kampojnë një pjesë të madhe të vitit, kope të shumta delesh dhe fise cigane.

Malet

Mali kryesor i pashallëkut të Prizrenit është Sharri ose Malet e Sharrit, në rrëzë të të cilit shtrihet qyteti i Prizrenit. Luboteni ngrit kokën rreth 6 500 këmbë dhe nga maja e tij mund të shihen, kur është moti i kthjelltë, anijet lundruese në gjirin e Selanikut. Në Perëndim të Prizrenit, të Gjakovë dhe Pejës, shtrihet një nyje malesh që bashkohen me ato të Mirditës dhe që formojnë vargmalet e Prislikut, Gorinikut, Mushticës dhe Shalës. Të gjitha

¹ Dokumenti është nxjerrë nga raportet e konsujve që kanë vepruar në Shkodër dhe Prizren. Agjencia e Arkivave të Kosovës, "Arkivi i Parisit" mikrofilm.

këto male janë të pasura me pisha, bredhë, ahë, bung dhe lisa shekullorë, të cilët përbëjnë lëndën e parë për të konstruktuar anije, sikur të shfrytëzohej ky pyll.

Fushat dhe lumenjtë

Qyteti i Prizrenit përshkohet nga Drini në tërë gjatësinë e tij, pesëdhjetë ura i bashkojnë dy brigjet e lumit. Drini i Bardhë, i cili kalon dy kilometra afër këtij qyteti, pasi kalon fushat më pjellshmëri të madhe bashkohet pranë Spasit me degën e Drinit të Zi, i cili vjen nga Ohri dhe nga këtu dredhen në detin Adriatik. Drini është lumi më i madh i pashallëkut; ai do të ishte shumë i rëndësishëm për tregti dhe bujqësi sikur të kishte mundësi të bëhej i lundrueshëm në të gjithë rrjedhën e tij. Bistrica, Merka, Sitnica, Ibri, Lepenci, Rieka dhe Graçanica, pas Drinit janë lumenjtë më të mëdhenj që në mes veti formojnë një sistem të ujitjes dhe që përrrenjtë që rrjedhin nga Mali Sharr dhe derdhen në Vardar e plotësojnë këtë mjaftueshëm.

Minierat

Minierat e mermerit dhe të porfirit ekzistojnë në Shkup. Një minierë e zhivës gjendet rreth njëzetë kilometra nga Gjilani, miniera të arit dhe argjendit në rrethinën e Janjevës, një minierë e argjend-bakrit është në Karatovë, një minierë qymyr fosilit në Pejë. Minierat pak të shfrytëzuara do të ishin një burim i pasurisë për këtë vend.

Popullata

Numri i banorëve të pashallëkut për shkak të mungesës së regjistrimit zyrtar do të llogaritet ndryshe; megjithatë do të mund të vlerësonim pa bërë ekzagjerime në shtatëqind mijë frymë. Në qytet elementi mysliman dominon, por në fusha sikurse edhe në male është i balancuar nga katolikët e të dy rriteve. Katolikët janë minoritet dhe sipas një vlerësimi të Kryepeshkopatës janë vetëm 5 847 frymë, pa i llogaritur 1 500 kolonë të Mirditës dhe 665 familje okulte. Popullata i përket racave shqiptare, serbe dhe bullgare. Myslimanët dhe katolikët i takojnë racës së parë. Shqipja, serbishtja, bullgarishtja, turqishtja dhe gjuha cigane janë dialektet e përhapura më së shumti.

Qytetet

Qytetet kryesore janë: Prizreni, Shkupi, Peja, Prishtina, Kalkandela (Tetova), Kupurlia (Veles), Kumanova, Vraja, Karatova, Kosova (Gostivari), Janjeva, Shtipi, Radoviqi, Golani (Gjilani) dhe Gjakova.

Prizreni

Ish-kryeqyteti i serbëve, atdhe i Justinjanit II, kryeqytet i pashallëkut të Shkupit, që varet nga Nishi, ka një popullatë prej 46 000 frymë prej të cilës 31 000 janë myslimanë, 10 000 grekë, 2 000 katolikë dhe 3 000 ciganë. Ai ka 11 340 shtëpi, prej të cilave 8 000 turke, 3 000 greke, 340 katolike. Ciganët përbëjnë një popullatë e cila nuk ka një vendbanim të caktuar. Ky qytet është i ndarë në 24 lagje ose mëhallë, që secila nga këto e ka një hoxhë bashi dhe kanë këto emra: Fersi, Hoxha, Haxhi Kasemi, Sossi, Muderizi, Sejdi Beu, Sinan Pasha, Varoshi, Kroshina, Ahmet Beu, Gsuhaxhi, Mahmudi, Dshedisi, Dergumani, Gjonaj, Skenderi, Kiutib Sinan, Currila, Ahmet Pasha, Bejzadi, Mahmud Pasha, dhe Jeni. Këto lagje kanë 26 xhami dhe 3 kisha greke.

Katolikët nuk kanë ende kishë të vetën. Ata shërbehen me një shtëpi të vogël në gjendje shumë të keqe për të shërbyer për lutje të shenjta. Prizreni është i mbrojtur nga një kala, ish-kështjellë e Mbretërisë serbe, mjaft mirë e ruajtur. Këtu banon një pasha si dhe një kryepeshkop latin, një prift i ritit oriental që paguhet me një shumë vjetore nga Kostandinopoja me 270 burse (3 3750 franga), një agjent konsullor i Austrisë dhe një vicekonsull i Rusisë. Klima këtu është mjaft e ndryshueshme dhe mjaft e ashpër në dimër. Qyteti gjendet në afërsi të maleve të larta. Sëmundjet më të shpeshta janë inflamacioni, ethe katarrale, gastriti, pneumonitë dhe oftalmitë të shkaktuara kryesisht nga ndikimet e të gjitha llojeve dhe nga papastërtia e rrugëve. Shumica e turqve kënaqen me një ves të pamoralshëm nga natyra, i cili shkakton në mesin e tyre përleshje të përgjakshme. Në lindje të qytetit, male të pashkelura e rrethojnë atë të Derventes të cilin edhe e mbronin e që sot gjendet në mes të një fushe të rrethuar me pemë të të gjitha llojeve, në mesin e të cilave mollët kanë një renome të madhe. Popullata është e përbërë nga 19 829 myslimanë, 505 grekë, 515 katolikë, 1 500 ciganë. Një rrugë motorike e rrethuar nga kodrina të vogla, gjarpëron drejt qytetit të Shkupit. Njëqind e pesë fshatra që numërojnë 28 000 banorë, përafërsisht të gjithë muhamedanë i takojnë këtij rrethi.

Uskiup ose Skopia (Shkupi)

Kryeqytet i Dardanisë së vjetër, seli e një kajmekami i vendosur mbi Vardar, prapa Maleve Seard dhe Orbel dhe rrëzë kodrinave më të ulëta, të cilat klimën e tij e bëjnë të rëndë. Ky ka një popullatë prej 28 000 frymë në mesin e të cilëve 19 000 janë myslimanë, 8 000 grekë, 800 katolikë dhe një

shifër përfaqësohet e barabartë çiftutë. Pjesa më e madhe e fushës së gjerë të Moravës është e banuar nga turqit dhe grekët ortodoksë. Ky qytet posedon shumë xhami të bukura, kisha greke, disa fabrika lëkurësh si dhe një pazar të madh dhe një urë të mrekullueshme, nën të cilën rrjedh lumi Vardar. Paralagjet e tij të formuara në veriperëndim nga këndi i Maqedonisë së vjetër janë: Aladia Hisar, Ohër, Manastir dhe Prizren.

Peja

Qytet i rëndësishëm prej 20 000 banorësh prej të cilëve më shumë se 15 000 janë myslimanë, 3 000 grekë, rreth njëqind katolikë dhe pjesa tjetër ciganë. Qyteti shtrihet rrëzë një zinxhiri malesh që përbëjnë burimin e Drinit të Bardh. Bistrica rrjedh në anën e përtej qytetit dhe në një distancë prej gjashtëmbëdhjetë kilometrash nga Peja ngre krye një manastir i madhërishtëm i Deçanit që ka 200 murgje. Pasi të kalohet Bistrica në një distancë prej 20 kilometrash në juglindje, shtrihet Gjakova.

Prishtina

E vendosur në një distancë prej gjashtëmbëdhjetë kilometrash nga Janjeva, tetëdhjetë e tetë nga Prizreni dhe njëqind e njëzet e pesë nga Nishi, pranë rrjedhës së lumit Ibër, supozohet se ka qenë qyteti i vjetër Prislava. Ky qytet i cili është pika ndarëse e rrugëve që shpijnë në Kostandinopojë, në Bosnjë dhe në Rumeli, ka një popullatë prej 11 000 frymësh prej të cilëve 7 000 janë muhamedanë, 2 500 grekë dhe rreth 1 500 çiftutë dhe ciganë. Mjaft i pasur dhe posedon një pazar shumë të bukur. Këtu bëhet një tregti jo shumë e rëndësishme, por që është mjaft i papastër. Dikur një pasha ka banuar këtu, por tani kjo është vetëm një seli e një mudiri dhe e një prifti grek. Pas një tatëpjete prej 12 kilometrash futemi në fushën e gjerë të Kosovës e cila ndahet nga Pejan në një distancë prej njëzetë kilometrash.

Kalkandere ose Tetova

E dominuar nga një kala, është i vendosur në mes të një fushe të rrethuar me pemë frutore të të gjitha llojeve, në mesin e të cilave mollët kanë një renome të madhe. Popullsia e saj është 19 829 myslimanë, 405 grekë, 515 katolikë dhe 1 500 ciganë. Një rrugë motorike e kufizuar me kodrina të vogla shpien nga qyteti i Tetovës në Shkup. Njëqind e pesë fshatra që numërojnë 28 000 banorë, gati të gjithë janë muhamedanë që e përbëjnë rrethinën e saj.

Kupurlia ose Kuprilia (Velesi)

Qytet me 2 000 shtëpi dhe 15 000 banorë i konstruktuar në amfiteatër dhe i rëndësishëm për tregti në veçanti për kultivimin e krimbit të mëndafshit që shitet në Itali dhe Francë. Ky ka një urë të mrekullueshme nën të cilën rrjedh lumi Vardar dhe ajo është pika qendrore e rrugëve të Bosnjës dhe të Shqipërisë së Sipërme (Veriore).

Kumanova

Qytet ky që gjendet në një luginë të mbuluar me drunj në mënyrë të trishtuar dhe është i ndërtuar jo larg Vardarit. Ai përmban rreth 300 shtëpi dhe 1 600 banorë që posedojnë numër të madh kope delesh, lesi i të cilave dërgohet në Selanik dhe teprica tjetër dërgohet në Sofje dhe Adrianopojë. Duke dalë nga gryka futemi në një fushë të kultivuar e rrethuar me male dhe e gjarpëruar shumë herë nga Vardari.

Kratova

Qytet i vogël ku ekspluatohet xehja e bakër-argjendit dhe ku ekzistojnë një numër i madh fabrikash të kazanëve dhe pajisjeve tjera të kuzhinës. Numëron rreth 6 000 banorë.

Kosova ose Gostivari

Këtë qytet ndryshe e quajnë edhe Kosovo Pole që vjen nga emri i fushës. Ky është Kosobus i vjetër dhe është i njohur vetëm nga dy betejat e mëdha të fituara nga Bajazit Murati më 1389 dhe 1448 mbi serbët, bullgarët dhe disa princa shqiptarë. Popullata përbëhet nga 4 000 boshnjakë dhe 2 000 shqiptarë. Në rrugët që shpijnë për në Vissa (Servi), Sanozë, Gracë, Babilmont, të cilët së bashku përbëjnë shifrën prej 1 000 katolikësh.

Janjeva

Qytet i vogël mjaft mirë i ndërtuar dhe ku kryhen punë mjaft të mira të argjendarisë dhe rreth dhjetë kilometra larg shtrihet fusha e Gracianaz (Graçanicës), e ujitur nga lumi i cili mban emrin e fushës dhe i banuar kryesisht nga grekët ortodoksë. Në qendër të kësaj fushe gjendet një tempull i vjetër i shkëlqyeshëm i vendosur gjashtëmbëdhjetë kilometra larg nga Prishtina.

Vrana ose Vraja

Qytet i vogël që ka shumë fabrika të bizhuterive të rreme dhe armë të luftës. Këtu punohen edhe instrumente fito sanitare.

Shtip ose Istib

Ne mendojmë se kemi të bëjmë me qytetin e vjetër të Stobit.

Radoviq

Qytet i vogël i konstruktuar pranë burimit të lumit me të njëjtin emër ose ndryshe e quajmë Strumnica (rrjedh nga Cakimos).

Golani ose Guilani (Gjilani)

Duke ndjekur fushën e Moravës drejt veriut, pas një rruge prej njëzetë kilometrash, gjendet ky qytet i vogël, i hapur me një popullatë turke dhe greke i mbështetur në tregti. Ky është qendra e një mudiri. Duke vazhduar për gjashtëmbëdhjetë kilometra rrugë që shpijnë në lindje kalohet nën kalanë e vjetër të Novobërdës, ku ka mbetur vetëm një pjesë e mureve të larta dhe të thepisura të kësaj kalajeje.

Jakova ose Giakova (Gjakova)

Shtrihet në qendër të një fushe pjellore e ujitur nga Rica, i cili derdhet në lumin Drini i Bardhë. Ky qytet ka një popullatë prej 25 000 frymësh, prej të cilëve 20 000 janë turq, 1 500 grekë, 1 200 katolikë, 1 700 ciganë dhe 600 çifutë. Një mudir banon këtu dhe sikurse në Pejë gjenden shumë kolonë mirditas që merren me kultivimin e tokës. Gjashtëmbëdhjetë kilometra nga ky qytet gjendet famullia e Zymit me 14 familje dhe 480 frymë. Duke kaluar Drinin dhe tetë kilometra më larg mbërrimë në Prizren.

Kultet, institucionet politike, organizimi politik, administratat dhe gjykatat**Kulti muhamedan**

Më shumë se gjysma e popullatës së pashallëkut praktikon religjionin mysliman dhe në qytete sikurse edhe në fshatra, ka një numër të konsiderueshëm xhamish. Shumica e këtyre xhamive të pajisura shumë mirë janë ish-kisha katolike dhe në njërin nga këto që gjendet në Prizren është i ruajtur ende kryqi.

Kulti oriental ortodoks

Greko-sllavët që janë në numër prej 250 mijë kanë gjithashtu kisha të pasura dhe manastire të mëdha. Në Shkup janë tri kisha, që njëra prej tyre nuk lë asgjë për të dëshiruar sa i përket arkitekturës dhe zbukurimeve të brendshme; në Prizren janë gjithashtu tri dhe e katërta së shpejti do të

përfundohet. Komuniteti ortodoks kontribuon mjaft shumë në shpenzimet që u ngarkohen për konstruktimin e tyre dhe në Shkup vetëm një familje ka kontribuar me një shumë njëzet mijë franga. Peshkopët ekzistojnë gati në të gjitha qendrat e mëdha, në atë të Shkupit është një metropolitan, juridiksioni i asaj i Prizrenit shtrihet edhe mbi pashallëkun e Shkodrës.

Kulti katolik

Kryepeshkop i Shkupit, i cili që prej kohësh është i vendosur në Shkup dhe i cili ende mban titullin, u detyrua në fund të shekullit XVII t'u nënshtrohet persekutimeve turke dhe iku në Padovë, ku qëndroi një kohë të gjatë para se ta caktonte rezidencën e tij në Janjevë, prej ku u transferua pastaj në Prizren. Ai pranon nga Austria një subvencion vjetor prej 400 florinjsh; çdo kryeplak pranon 80 dhe misionari i thjeshtë 60. Divizioni i Shkupit është i ndarë në gjashtë famulli të cilat tabela e mëposhtme i paraqet emrat, shtrirjen dhe popullatën katolike të cilën e përfshin.

<i>Paraqitja e famullive</i>	<i>Shtrirja në Kilometra</i>	<i>Katolikë</i>		<i>Okultë</i>		<i>Gjithsej</i>	
		<i>Familje</i>	<i>Individë</i>	<i>Familje</i>	<i>Individë</i>	<i>Familje</i>	<i>Individë</i>
<i>Prizreni (supozimi)</i>	60	137	724	200	1550	337	2174
<i>Cinagora (supozimi)</i>	8	103	760	150	1050	253	1810
<i>Janjeva (Sh. Nikolla)</i>	40	132	792	120	900	252	1592
<i>Peja (Sh. Katarina)</i>	64	62	553	165	1115	227	1468
<i>Gjakova (Sh. Petri dhe Sh. Poli)</i>	60	410	2735	20	140	430	2875
<i>Zymi (supozimi)</i>	8	44	483	10	80	54	563
<i>Gjithsej</i>	240	888	5847	665	4735	1553	10,582

Famullia e Prizrenit ka 22 fshatra: Zhiligradhda, Vranica, Stavrova, Ludoviku, Tupeci, Lapushniku, Karvasaria, Nishori, Ladroci, Pavori,

Dragaçina, Vërsheci, Krushica, Krajmeroci, Vukasi, Androzi, Papasi, Sevbara, Bresalci, Doresan, Skiaroci dhe Presta.

Ajo e Cingores 10 fshatra: Verneskola, Vranavokolo, Letnica, Sasara, Stublla, Binça, Leshkobare, Karadaku, Dunovi dhe Stanci, që janë të banuar vetëm me katolikë.

Ajo e Pejës 25 fshatra: Bellaj, Belegu, Lugu, Lumbardhi, Broliqi, Brusazi, Papiqi, Zillopeku, Zuriaga, Berane, Dosgjiana, Labiani, Shtupeci, Lubizhda, Musovini, Kraçeva, Novosella e Ultë, Novosella e Epërme, Gllogjani, Prekorupa, Gregoviqi, Ujmiri, Dobërdoli, Zavoriku dhe Prociza.

Ajo e Gjakovës 53 fshatra: Dujaka, Skiviani, Prelepi, Rustavica, Planqori, Bradaneshi, Lugajat, Zabeli, Rastica e Ultë, Rastica e Sipërme, Dubrava, Gramaçeli, Pallabardhi, Ganishi, Trakaniqi, Dolibari, Zhdrella, Beci, Vraniqi, Brodosani, Ramoci, Bojaj, Shishmari, Smolica, Belegu, Lluka, Shiapeti, Oseku i Ultë, Oseku i Pashës, Meja, Korenica, Firza, Babai, Qerimi, Marmora, Muglica, Rasa, Petrosana, Doli, Smaqi, Bistazhini, Kushiaveci, Guska, Drere një pjesë e Novosellës së Ultë dhe e Novosellës së Sipërme.

Ajo e Zymit 4 fshatra: Rugova, Remaja, Dedaj dhe Bytyç, ku të gjithë janë katolikë.

Okultet (të fshehurit)

Ashtu siç kemi pasur mundësi nga tabela paraprake, katolikët okultë ishin rreth 665 familje që kishin 4 735 anëtarë, të cilët banon në fusha dhe male, ku jetonin në mesin e katolikëve tjerë dhe turqve. Fshatrat që banonin ata janë në famullinë e Prizrenit: Zillograxha, Vranica, Savrova, Nishori, Krajmeroci, Karvasari, në atë të Janjevës: Androzi, Papazi, Skobara, Bresalci; në atë të Zagories: Stublla, Binça, Leshkobare, Karadaku, Dunova dhe Stonci; në atë të Pejës: Zillopeku, Zuriaga, Barani, Shtupa, Krusheva, Zavoriku, Gregoviqi dhe Prociza, në atë të Gjakovës: Marmora, Belegu, Palabardhi, Ganoshi dhe Brodosana dhe së fundi në atë të Zymit: Dedaj dhe Bytyçi. Këta të krishterë nganjëherë deklarorin publikisht kultin e tyre dhe vetëm pas okupimit të vendit nga armata otomane dhe persekutimet që e përçollën këtë okupim i detyruan familjet që të pranojnë me armiqësi islamizmin, por që gjithnjë fshehurazi e praktikonin kishën katolike.

Më shumë se njëherë, që nga vendosja e dominimit mysliman në këto anë, që do të thotë nga viti 1454 dhe deri në kohën e tashme, këta katolikë bënë përpjekje të kota për t'u liruar nga zgjedha që peshonte mbi ta dhe mbi

lirinë e tyre të vetëdijes, por gjithnjë të frikësuar nga fati i ashpër dhe barbarë që pasha i bënte të vuajnë, ata të cilët merrnin guximin të manifestonin publikisht fenë katolike, tentativat e tyre bëheshin gjithnjë e më të rralla. Abrogimi i ligjeve drakonike nga Porta në vitin 1846, të cilët deri më tani ishin në fuqi për çështje të tilla dhe intervenimi efikas i fuqive katolike në favor të bashkëfetarëve të tyre në përgjithësi e në veçanti për kriptokatolikët të famullisë së Shkupit, këtyre të fundit ua kthej guximin të këmbëngulin në fenë e tyre dhe kleri duhej të bënte përpjekje që t'i ruante në kishën e tij.

Gjithashtu në dhjetë vjetët e fundit konvertimet e okultëve (të fshehurit) ishin më të shpeshta pa u kundërshtuar, kjo në mënyrë më serioze nga Porta; kështu pa folur për konvertime parciale të cilat vazhdonin dhe që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite, mund të citojmë se në maj të vitit 1858 gjashtëmbëdhjetë familje të Mudirllëkut të Golanit përfituan nga prania e një komisioni ushtarak otoman në këtë qytet, i ngarkuar të përpilojë një listë për regjistrimin ushtarak dhe kaluan në katolicizëm. Guvernatori Akif Pasha thjesht për të informuar Portën dhe për ta paraqitur këtë fakt si pasojë e intrigave të klerikut latin, për të cilat prifti i Zagores D. Gasparo Krasniqi ishte akuzuar se kishte gabuar.

Në shkurt të 1859 njëzet e pesë familje të të njëjtit rreth e mohuan islamizmin dhe kaluan në katolicizëm pa më të voglën pengesë nga ana e guvernatorit Osman Pasha, i cili u mjaftua me rekomandim për kryepeshkopin që ishte një maturi e madhe ngaqë nuk u provokua asnjë çrregullim në mesin e myslimanëve. Duhet të supozojmë se qoftë për shkak të interesit qoftë për shkak të bindjeve, familjet okulte të cilat ekzistonin ende do të përcjellin shembullin e atyre, të cilat tashmë kanë deklaruar fenë e tyre dhe që kanë pasur mundësi ta ruajnë pa u ndëshkuar për të kaluarën, por për ta përmbushur këtë qëllim ishte e domosdoshme që fuqitë katolike të vazhdojnë që t'u akordojnë mbështetjen e tyre në Kostandinopojë, në mënyrë që Porta të mbahet në dispozicion të favorshëm për çfarë duket se është e gatshme për këtë klasë interesante për çështjen e Sulltanit. Në fakt që prej gjashtë vjetësh qeveria otomane ka bërë koncesione të konsiderueshme për katolikët e Shkupit, qoftë në vazhden e demarsheve të bëra nga Franca dhe Austria, qoftë ato të bëra nga propaganda e organit të Arqipeshkisë armene-katolike të kryeqytetit të Mbretërisë.

Këto demarshe kanë shtyrë që në shkurt të vitit 1859, një letër e vezirit të urdhërojë qeverinë e Prizrenit që t'u lejon okultëve lirinë për të pasur mundësi ta përqafojnë katolicizmin dhe të mos i ngacmojë fare për këtë ndryshim të fesë dhe të angazhohen për të marrë masa të nevojshme që ta pengojë zhvillimin e fanatizmit mysliman.

Ky koncesion, për aq më tepër është i rëndësishëm për Portën që të mos i konsideron këto konvertime ndryshe, por vetëm si një akt apostazie dhe se duhet të konsiderohet vetëm si një largim nga e kaluara. Më 19 nëntor të të njëjtit vit, një letër e dytë nga veziri që barte datën e 23 Rebiul aKhir 1276, që përmbante dispozitat e mëposhtme, i është dërguar të njëjtit guvernator. “Të gjithë katolikët okultë të cilët e kanë deklaruar fenë e tyre para kohës së rekrutimit ushtarak, do të përjashtohen nga të gjitha shërbimet aktive në ushtri dhe do të paguajnë vetëm taksën e përjashtimit (Bedelie ose Iane – i – askerie). Kurse ata të cilët ngaqë janë rekrutuar, janë deklaruar katolikë, me gjithë këtë deklarim ata duhet t'i nënshtrohen shërbimit ushtarak, ngaqë një deklarim i tillë i vonuar do të konsiderohet vetëm si një ikje e rrejshme nga ky obligim dhe jo rezultat i një bindjeje religjioze”.

Kjo letër e fundit e vezirit, e cila në të njëjtën kohë implikoi ndryshimet e nevojshme në listat e myslimanëve që i nënshtrohen rekrutimit çdoherë, kur njëri nga ata deklarohet katolik, nëse kjo është ekzekutuar me paanshmëri, sigurisht çështja e okultëve tashmë do të gjejnë një zgjidhje, por neglizhenca ose besimi i gabuar i nëpunësve të ngarkuar me rekrutimin që përmbajnë listat e katolikëve të pranuar si të tillë dhe që inkorporohen në armatë megjithëse kanë bërë deklarimin e tyre, ka bërë që çështja të mbetet pezull dhe ka rritur numrin e të pakënaqurve dhe ka shkaktuar pengesa për Portën. Një revizion i saktë i listave do të mund ta rirregullojë pozitën sociale dhe religjioze të kriptokatolikëve dhe ky revizion do të duhej të bëhej sa më shpejt që është e mundur, në prani të fretërve përkatës ose të një komisioni të katolikëve.

Rregullimi publik

Turqit në Prizren kanë shtatëmbëdhjetë shkolla fillore për çuna, nëntë për vajza të reja dhe një gjimnaz ushtarak të quajtur Mekteb-i-arbie ku mësimdhënia është shumë sipërfaqësore, shumë shkolla tjera private ekzistojnë në qytetet tjera të pashallëkut. Sllavo-grekët e kanë një shkollë në Prizren, një tjetër në Prishtinë, dy në Shkup dhe një e tretë do të duhej të hapej

kohëve të fundit. Në këto shkolla të financuara nga komunitetet, serbishtja është gjuhë të cilën shkollarët e mësojnë. Katolikët e kanë një shkollë në Prizren, e cila që nga 1856 është subvencionuar nga Austria dhe ajo frekuentohej në vitin 1863 nga tridhjetë e gjashtë nxënës, për të cilët gjuha italiane ishte si gjuhë parësore.

Organizimi administrativ

Dikur Shkupi përbënte një sanxhak që varej nga Rumelia. Velesi, në vitin 1843 ishte ngritur në pashallëk të pavarur dhe atij ia bashkëngjiten vilajetin e Prizrenit. Gjatë revoltave të Bosnjës, vendi i qendrës ishte bartur në Prizren, me qëllim që të jetë i vendosur në mes të rrugës e cila shpinte në këtë krahinë. E njëjta gjë ndodhi më Shkodrën, ku që prej asaj kohe Porta autoritetin e saj e ushtronte në pashallëk me të punësuar me rrogë të angazhuar nga ajo vetë. Pas shfuqizimit të sistemit feudal, vendi administrohej nga pashai trashëgimtar. Ata bënë luftë në mes veti gjithnjë dhe nga Sulltani ata përfitonin disa të ardhura minore vjetore të cilat pak a shumë paguheshin me saktësi.

Territori që formon vilajetin e Shkupit të ditëve tona ishte nën varësinë e shtatë pashallarëve, të cilët jetonin në Gjakovë, Pejë, Prishtinë me aneksin e Janjevës, Vuçitërnë dhe Mitrovicë; Vraja me rrethinat e Gjilanit (Golanit në tekst); Shkupi me rrethinat e Kumanovës, Karatovës, Shtipit, Palancës, Koshava dhe Kaçaniku; Tetova me rrethinat e Kosovës dhe Kërçovës dhe së fundi në Prizren. Aktualisht vilajeti i Shkupit administrohet nga një pasha që banon në Prizren, me dy kajmekamë, njëri në Shkup dhe tjetri në Pejë, duke pasur nën mbikëqyrje dhjetë mudirë që udhëheqin me nënrrethet e Kumanovës, Karatovës, Palankës, Korsanës, Vrajës, Gjilanit, Prishtinës, Vuçitërnës, Gjakovës dhe Calcandeles që përbëhet nga fusha e Tetovës dhe fshatrat që shtrihen në jug të Sehares. Tri të parat janë nën varësi të plotë të kajmekamit të Shkupit dhe gjithë të tjerat nën varësi të atij të Prizrenit. Pashallëku ka qenë i pavarur deri në fillim të vitit të kaluar, që nga kjo periudhë dhe me qëllim të një kursimi, i cili nuk mund të shpjegohet, ka gjithnjë numër të njëjtë të të punësuarve, është vendosur në rrethin e valiut të Nishit.

Mbrojtja shtetërore

Natyra është përfshirë nga pushteti dhe këtë e shpjegojnë me gjendjen e keqe të rrugëve dhe për shkak të mungesës së mënyrave të komunikimit nga

një vend në tjetrin të krahinës. Kështjellat e vendosura në qytete, me përjashtime të rralla, nuk janë gjë tjetër vetëm një grumbull gërmadhash nga gurët duke pasur në muret e tyre të vendosur topa jashtë përdorimit, që u janë besuar artiljerëve veteranë të cilët nuk dinë se çfarë të bëjnë me ta kur kërkohet nevoja e përdorimit të tyre.

Forcat e armatosura

Nuk ekziston asnjë garnizon i përqendruar, kur prania e trupave të rregullta kërkohet, manastiri dërgon numrin e detashmenteve që duken se janë të nevojshme. Kujdesi për ta rijetuar qetësinë publike i është besuar xhandarmërisë lokale (Zaptive) të përbërë, sikurse edhe në pjesët tjera të mbretërisë, nga njerëz të klasave më të ulëta, që lënë shumë për të dëshiruar në të gjitha raportet. Këta zapti të cilët as nuk ushqehen, as nuk vishen dhe as nuk armatosen nga pushteti, marrin vetëm një rrogë si lëmoshë të pamjaftueshme prej 20 frangash në muaj me të cilën duhet të ballafaqohen me të gjitha shpenzimet e jetës. Prandaj, nuk duhet të habitemi që ata e favorizojnë vjedhjen dhe grabitjen dhe që bëjnë kaq shumë të pabëra.

Mentaliteti

Ligji i Tanzimatit është futur vetëm me emër në pashallëk, çarmatosja e popullatës, kryesisht të asaj të bjeshkëve, deri më tani është kryer mjaft pjesërisht. Myslimanët të cilët janë të gjithë të armatosur, ruajnë ende barbaritë e vjetra dhe ushtrojnë pa u ndëshkuar tërë despotizmin e tyre mbi fatkeqësinë mbretërore. Të krishterët e kësaj krahine sikurse ata të Shqipërisë së Lartë (Veriut) janë të përkushtuar ndaj Sulltanit, por ata ngrenë krye kundër administrimit të keq dhe babëzive të autoriteteve provinciale. Dëgjohen shpesh të flasin për përmirësimin, por që asnjëherë nuk i panë efektet e këtyre ndryshimeve. Ata nuk kanë më besim në premtime që pashai dhe mudirët i proklamojnë me të ardhur këtu dhe pastaj i harrojnë. Ata i urrejnë turqit, sepse ata janë të shtypur nga ana e tyre, por do ta preferonin dominimin e tyre në krahasim me popujt tjerë, sikur të kishin mundësi ta praktikonin lirshëm religjionin e tyre, për të cilin janë të lidhur shumë dhe sikur të ishin më pak të shtypur nga agjentët e rinj. Greko-sllavët që prej kohësh kanë simpati për Rusinë, e cila është shumë bujare në respektimin e kultit ortodoks, por besohet se ata dëshirojnë që dominimi mbi ta është një gabim i rëndë dhe sikur njëherë e mirë të liroheshin ëndërrojnë emancipimin e tyre, i cili është në favor të rivendosjes së Mbretërisë së gjerë serbe.

Gjykatat

Dy gjykata, njëra Penale dhe tjetra Komerciale funksionojnë në Prizren. E para përbëhet nga një kryetar dhe nga tre gjykatës, e dyta nga një kryetar dhe nga pesë anëtarë të tjerë. Gjykata penale mund të shqiptojë deri në tri vjet burgim, kurse sa u përket krimeve të rënda dhe delikteve, gjykatësit duhet t'i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Lartë në Kostandinopojë. Burgjet janë në gjendje të mjerueshme, por megjithatë këto ekzistojnë në tërë Turqinë, një i burgosur merr vetëm 500 gramë bukë në ditë. Dëshmia e një të krishteri para gjykatave të organizuara dhe kadisë, pranohet vetëm kur kjo nuk ka të bëjë me myslimanë, por ciganët publikisht praktikojnë religjionin e muhamedanëve, pranohen si dëshmitarë mjaft lehtë dhe për shpërblim të ulët ata dëshmojnë në favor të atij që i paguan dhe kjo pranohet pa ndonjë problem.

Taksat

Taksat e përshkruara nga Tanzimati janë mbledhur rregullisht; myslimanët që sipas ligjit janë caktuar të rekrutohen, çfarë nuk është aplikuar asnjëherë, kurse të krishterët janë të detyruar të kryejnë Beledien apo Nizamin (Iane-i-askerie). Ekzistojnë taksa të cilat u ngarkohen vetëm këtyre të fundit, kështu, të gjithë të krishterët që kalojnë fshatin e vogël të Kaçanikut janë të detyruar të paguajnë një piastër (20 qindarkë); të gjithë të krishterët që hyjnë në Shkup duhet t'i nënshtrohen taksës prej dhjetë parash (pesë qindarka), nëse është i huaj në qytet paguan gjashtë para (3 qindarkë). Një veturë fjetje me katër rrota që është pronë e një të krishteri dhe që futet në qytet me ushqime, paguan një piastër, por nëse ka dy rrota paguan pesëmbëdhjete para. Këto tatime janë një padrejtësi e madhe, sepse së paku duhej të ishin për të gjithë banorët njësoj pa diskriminim fetar.

Të ardhurat

Të ardhurat e Qeverisë në territorin e vetëm të Prizrenit në vitin 1863 kanë qenë 2 250 mijë piastra (563 mijë franga) 600 mijë piastra që vijnë nga importi i të vjelave; 400 mijë nga bagëtia; 1 200 mijë nga pasuria e patundshme, 50 mijë nga pasaportat dhe letrat me stemë.

Telegrafët

Një linjë elektrike i mundëson Prizrenit, Shkupit dhe Pejës të korrespondojnë me Manastirin, Selanikun, Kostandinopojën dhe me të gjitha

vendet tjera. Stacionet telegrafike ekzistojnë ndërmjet Prizrenit, Shkupit, Prishtinës, Novi-Pazarit dhe Nishit.

Bujqësia, blegtoria, industria dhe tregtia

Bujqësia

Bujqësia është ende gati si në të gjitha pashallëqet përbrenda shtetit të fëmijërisë dhe që prej shumë shekujsh ajo nuk ka bërë asnjë progres. Është e vërtetë që popullatës nuk i mjafton kultivimi i një toke kaq të gjerë, kjo tokë mund të punohet shumë më mirë dhe të jep rendimente më të kënaqshme. Shkaqet kryesore të kësaj gjendjeje së pari janë mungesa e mundësive dhe pastaj fshatari duke qenë më shpesh vetëm fermer i terrenit që shfrytëzon vepron në atë mënyrë duke dashur t'u shpëtojë taksave, kultivon vetëm pjesën më të vogël të terrenit aq sa është e nevojshme për të mbështetur familjen e tij. Këtyre shkaqeve duhet shtuar atë të gjendjes së keqe të veglave bujqësore të zgjedhura saktësisht nga ai. Me të vërtetë, është për të ardhur keq që një krahinë kaq e pëlleshme, ku ka fusha të gjëra të ujitura nga të gjitha anët të japë rendimente kaq të ulëta. Misri, elbi, gruri, tërshëra, thekra, pak oriz, vreshtat, duhani dhe frutat e të gjitha llojeve, përveç fikut janë prodhimet kryesore të tokës. Korrija e drithërave është me bollëk. Ullinjtë, bajamet dhe dafinat këtu janë të panjohura.

Rritja e bagëtisë

Rritja e bagëtive është sikurse bujqësia në gjendje primitive. Rritja e gjedhit është më e prapambetur. Raca e deleve është në përkujdesje më të madhe dhe ato prodhojnë sasi të konsiderueshme leshi që një pjesë e tij eksportohet në Maqedoni. Raca e kuajve është e begatshme vetëm në rrethinat e Shkupit dhe në fushat e Kosovës.

Industria

Vetë qyteti paraqet disa gjurmë industriale. Gati e gjitha përqendrohet në prodhimin e armëve. Duhet pranuar se janë të punuara në mënyrë të admirueshme, në prodhimin e çarçafëve dhe qilimave nga leshi për të cilët janë të njohur greko-sllavët; në përgatitjen e një cilësie të lartë të lëkurave dhe në veçanti kjo bëhet në Prizren dhe në Shkup, ku ekzistojnë fabrika për përpunimin e lëkurës me cilësi mjaft të lartë. Argjendaria është mjaft e pranishme dhe përpunimi i veglave të argjendit bëhet në Janjevë mjaft mirë.

Mjeshtëritë tjera janë të dorës së dytë dhe pak të ushtruara. Prodhimi i armëve është një specialitet i katolikëve.

Tregtia

Prizreni është qendra ku vijnë dhe bashkohen veriu dhe veriperëndimi i pashallëkut. Pa komunikacion direkt me vendet tjera, ai varet nga disa rrethe, si: Gjakova, Peja, Prishtina dhe Gjilani, e në veçanti nga ai i Shkodrës, prej ku pranon prodhime austriake dhe mallra koloniale të nevojshme për konsumim. Pazari i tij është mjaft mirë i furnizuar, por bartja e mallrave bëhet me vështirësi dhe rezultatet në vazhdim të luhatjeve që pëson këmbimi, mungesa e parave të gatshme dhe mungesa e prodhimeve rajonale që do të mund të lehtësonin mënyrën e rimbursimit, janë përafërsisht negative dhe mezi u mundësojnë negociuesve, të cilët në asnjë mënyrë nuk merrem me zanatin e fajdexhinjve, që ta vendosin një balancim në mes të transaksioneve të hyrjeve dhe atyre të daljeve.

Sikur Drini, i cili është më i gjerë se Rona, të ishte i lundrueshëm për tonazhe të vogla deri në afërsi të Prizrenit, çfarë kanë kërkuar prej kohësh shumë qeveri që të bëhet, sikur fusha e bukur e Kosovës të ishte e vendosur në një shkallë më të lartë për mirditasit ose emigrantët çirkezienë, sikur në fund tregtarët dhe industrialistët tjerë të huaj, të vendoseshin në këtë qytet dhe të kishin një siguri të plotë, është e sigurt që për pak vite ky qytet do të lulëzonte sikurse kur ka qenë nën mbretin serb. Popullata e tij barbare do të civilizohej që do ta shijonte më mirë punën, kështu Porta otomane do t'i qindfishonte të ardhurat. Shkupi luan rolin e njëjtë sikur Prizreni dhe do të furnizonte Kratovën, Pallankën, Korsanën. Tregu i tij është i furnizuar nga Selaniku. Vetë rrethi i Kalkandeles (Tetovës) sjell nga Shkodra mallra të cilat i janë të nevojshme. Importimi përqendrohet në shami të qëndisura, në manifaktura të pambukut, në gryka të pushkëve dhe në mallra ushqimore. Importohet gjithashtu një sasi e madhe e kripës. Vlera e importit është 5 500 mijë franga për një vjet. Eksporti vjetor bëhet me Triesten, Venedikun, Francën, Italinë dhe Egjiptin përmes rrugës së Selanikut dhe të Shkodrës:

Sasia në kilogramë Shuma	
10 000 kilogramë farë të krimbit të mëndafshit.....	2 000 000 fr.
30 000 kilogramë mbushje me mëndafsh.....	450 000 fr.
260 000 kilogramë lesh të klasës I dhe II.....	156 000 fr.
150 000 kilogramë lëkurë të lepurit.....	130 000 fr.
150 000 kilogramë lëkurë të regjura.....	250 000 fr.
150 000 kilogramë të drithërave.....	2 000 000 fr.
<u>Gjithsej.....</u>	
	6 390 000 fr.

Lëvizja tregtare është shndërruar në një faktor mjaft të rëndësishëm në mes Shkupit dhe Selanikut që një rrugë motorike do të zhvillonte edhe më mirë sikur qeveria otomane do të angazhohej pak më shumë për përmirësimin material në pashallëk. Një pjesë mjaft e madhe e vjeljes së duhanit dërgohet në Sarajevë dhe Servia pranon shumicën e armëve të prodhuara në krahinë.

Rrugët e komunikacionit

Varësia tregtare në të cilën gjendet Prizreni, në krahasim me Shkodrën dhe jo lundrueshmëria e lumit Drin janë më tepër se të mjaftueshme për të përcaktuar nevojën për të konstruktuar një rrugë që përdoret nga karrocet, sepse mjeti i vetëm i komunikacionit në mes këtij qyteti dhe Prizrenit është rruga e vjetër e karvanëve që përdoret edhe sot, e cila pa asnjë riparim, shërben që prej shumë shekujsh dhe për ndryshe është në një gjendje dëshpëruese. Kjo rrugë që ka një gjatësi prej rreth 136 kilometrash është ndërtuar në një shkretëtirë ku udhëtarët nuk mund të gjejnë asnjë strehim dhe as edhe ushqim. Gjatë kohës së mirë mund të kalohet për së paku tri ditë apo më së shumti për katër, ku gjatë dimrit duhen nga tetë në pesëmbëdhjetë orë.


Marrja me qira e ndonjë kali që do të mund të barte pesha prej 150 kilogramësh kushton nga 23 deri 30 franga sipas sezone. Edhe pse distanca në mes Shkupit dhe Selanikut është dy herë më e gjatë mund të kalohet për një kohë më të shkurtër. Kjo distancë nga Selaniku në Kelkez është 36 kilometra.

Drejtimit	Distanca në kilometra
Nga Kelkezi në Doiran	24 kilometra
Nga Diorani në Strumicë	24 kilometra
Nga Strumica në Shkup	32 kilometra
Nga Shtipi në Kupurli	72 kilometra
Nga Kupurlia në Shkup	40 kilometra
Gjithsej:	252 kilometra

Sa u përket rrugëve të komunikacionit në pashallëk ato janë edhe më të pazhvilluara dhe natyra i ka kryer të gjitha shpenzimet e riparimit. Megjithatë ato ende preferohen dhe kryesisht rrugët që shpijnë nga kryeqyteti në Shkodër.

Shkodër, më 8 maj 1864

E. Ivet.



Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës.

Fondi i Parisit, viti 1862, kutia Nr. 3 kati i IV: Korrespondenca e konsujve
frëngj në Shkodër, për çështjen shqiptare gjatë viteve 1860-1870.